REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 714-718-720-721/20
Datë/Datum. 16.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Gjemajli Bellanica	06.10.2020	16.10.2020	*714/20; 718/20 720/20; 721/20*
Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24,25,26.09.2020, **OE "Oltitrasing" Sh.p.k.; GOE "Edona" Sh.p.k; "Company Murseli" Sh.p.k "Suvatimi" Sh.p.k; GOE "AC ing " Sh.p.k & "A CON" Sh.p.k; dhe OE BM Grup Sh.p.k** kanë parashtruar ankesë me nr: 714/20; 718/20; 720/20; 721/20 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë **GOE "Globi –M.I" SH.P.K.;N.N.P "EURO CONSTRUCTION"** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndërtimi i ri i stacionit të Autobusëve**" , me nr. të prokurimit:**651-20-2311-5-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Kuvendi Komunal - GJILAN.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, Punë, vlera e parashikuar e kontratës:**760 278.18 €**.

Data e njoftimit për kontratë.....29.05.2020.
Data e hapjes së ofertës.....21.07.2020.
Data e njoftimit për dhënien e kontratës.....09.09.2020.
Data e njoftimit të ofertuesve të pasuksesshëm.....09.09.2020.
Data e kërkesës për rishqyrtim .....14.09.2020.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim:.....16.09.2020.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE "Oltitrasing" Sh.p.k.;GOE "Edona" Sh.p.k; "Company Murseli" Sh.p.k "Suvatimi" Sh.p.k; GOE "AC ing "Sh.p.k & "ACON" Sh.p.k; dhe OE BM Grup Sh.p.k

Dispozitat e pretenduara që janë shkelur nga AK

Neni 1 - Qëllimi
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 - Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 64 - Dëshmitë e kërkesave
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
Neni 40 - RROUP
Neni 41 - RROUP

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet OE "Oltitrasing" Sh.p.k

Në Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues propozon që me kontratë publike për aktivitetin e lartcekur të prokurimit të shpërblehet oferta e Grup i Operatorëve Ekonomik Globi – M.I. SH.P.K..; EURO CONSTRUCTION për një shumë 729,542.20€
Në arsyetim të njoftimit Letër standarde për tenderuesin e eliminuar sqaroni:
"Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:
Komisioni i vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave ka konstatuar se oferta e juaj është e papërgjegjshme lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale, për arsyet si më poshtë:
Komisioni gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave duke u bazuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë gjegjësisht të Kapaciteti teknik dhe profesional 9.1 & 9.2 në kërkesen 2 sipas dosjes së tenderit DT është kërkuar që: - Operatori ekonomik duhet të angazhoj përsonelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të më poshtme, 4 (katër) saldues të çërtifikuar.
Në dosjen e ofertuar nga ju si **Grup i Operatorëve Pro & Co Goup SH. P. K.; N.N.T. A.B. C.** Komisioni i vlerësimit ka konstatuar se ju mungon validiteti i çërtifikatave për saldator, sepse të 4 (katër) salduesit e paraqitur, sepse çërtifikatat kanë afat validiteti prej 3(tre) vite, mirëpo duhet që për çdo vite të bëhet rilëshimi i çërtifikimit, ku këto çërtifikikata janë lëshuar më 27/11/2018 dhe nuk është bërë më data e rilëshimit, po ashtu nuk ka as kontratë as CV e as ndonjë referencë për punën e tyre".
Si duket këtu Autoritetit kontraktues Komuna e Gjilanit - Drejtoria e Prokurimit iu kanë ngatrruar gjërat, në vend se të shënoi titullin si duhet të kompanisë tonë Olti Trasing Sh.p.

k. 810514291, ka shënuar *Grup i Operatorëve Pro & Co Goup SH. P. K.; N.N.T. A.B. C.* ku titulli i kësaj kompanije fare nuk figuron në procesverbalin e hapje së ofertave që ka ndodhur më 21/07/2020 si dhe në tabelen të cilën ia keni bashkangjitur B58 – Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 09/09/2020

Arsyetimin të cilin e ka shënuar në Letër standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 09/09/2020 nuk qendron, sepse faktet janë në ralitet se salduesit për të cilët pretendon janë të cërtifikuar në procedurë të regulltë ashtu siç e kërkon institucioni i cili i lëshon cërtifikatat përkatëse EAS INTERNATIONAL për të cilin institucion i keni të dhënat në pjesën e poshtme të këtyre cërtifikave përmas të cilave të dhëna ju mund të komunikoni dhe të informoheni për vlefshmërinë – validitetin e tyre. Ky institucion i lëshon cërtifikatat për tri (3), ndërsa ka institucione që cërtifikatat ndoshta i lëshojnë vetëm për një (1) vit që është në kompetencen e tyre.

Provë:

Certifikatat e punëtorëve saldues të gjithë këta puntorë kanë kontrata pune me kohë të caktuar kanë CV-në si dhe referncat përkatëse për punët të cilat i kanë kryer.

Të gjitha këto do i bashkangjitën kësaj ankese edhe pse të gjitha kanë qenë të dërguara së bashku me dosje të tenderit, por si duket juve iu kanë ngatrruar me ndonjë ofertë të operatorit tjetër.

Këtu më poshtë po i shënojmë të gjitha të dhënat për punëtorët saldues që sipas juve janë kontestues.

1. ***I Përparim Statovci Saldues Certificate of achievment lëshimi 08/11/2018 e vlefshme deri më 07/11/2021, pesedon kontratë punë CV dhe Referenë përkatëse;***

2. ***Gazmend Selmani Saldues Certificate of achievment lëshimi 08/11/2018 e vlefshme deri më 07/11/2021 pesedon kontratë punë CV dhe Referenë përkatëse;***

3. ***Bedri Salihu Saldues Certificate of achievment lëshimi 08/11/2018 e vlefshme deri më 07/11/2021 pesedon kontratë punë CV dhe Referenë përkatëse;***
4. ***Nehat Sekiraça Saldues Certificate of achievment lëshimi 08/11/2018 e vlefshme deri më 07/11/2021 pesedon kontratë punë CV dhe Referenë përkatëse;***

Për të vërtetuar këte që kemi shkruar më lartë, ne ditë më parë iu kemi drejtuar institucionit EAS CERTIFICATION CERTIFICATION AND CONTROL i cili i ka lëshuar këto certifikata, me datë 24/08/2020 kemi pranuar këtë përgjigje të cilen po iu dërgojmë të skanuar në gjuhen angleze dhe të përkthyer në gjuhen shqipe.

Dhe për fund është shqetësuese se si komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues i cili ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave për aktivitetin e lartë cekur të prokurimit nuk ka mundur t'i verifikoj ato cërtifikata se janë apo nuk janë në rregull, por si duket qellimi ka qenë që me kontratë publike të shpërblehet oferta e operatorit ekonomik me çmimin më të lartë

Çdo justifikim i mundshëm i juaji në cilësinë e Zyrtarit Përgjegjes të Prokurimit nuk mund të mbështetet me asnjë normë ligjore dhe as etike — profesionale, këtë duhet të keni parasysh ngase jeni duke ushtruar një funksion publik që iu është besuar të ushtroni profesionin, të kryeni detyrat me kompetencë dhe përgjegjësi, ndërshmëri, besnikëri dhe në pajtim me ligjin.

Ju z. Kurteshi në cilësinë e Zyrtarit Përgjegjes të Prokurimit i autoritetit kontraktues, Kuvendi Komunal i Gjilanit nuk keni bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ashtu siç e rregullon neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve). i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, dhe neni 41 i RRUOPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve). çka duhet të jeni të vetdijshem se mund të bartni pasoja deri të marrja e përkohshme e certifikatës themelore të profesionalizmit në prokurim si dhe të gjobitet autoriteti kontraktues Kuvendi Komunal i Gjilanit me një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare, nëse edhe më tutje vazhdoni me kokëfotësi t'iu përmbaheni qëndrimeve tuaja pa kurfarë mbështetje ligjore.

Në përfundim të prezentimit të argumenteve përmes kësaj Ankese kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-së që t'i propozoi Panelit Shqyrtues të OSHP-së të aprovojnë Ankesën e Operatorit Ekonomik ekonomik "Olti Trasing" Shpk – Sheshi Bill Klinton, pn.- Prishtinë, Rep. e Kosovës, p.n dhe i tërë aktiviteti i prokurimit të këthet në ri-vlerësim dhe të urdhëhohet autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit - Departamenti i Prokurimit të bie këtë:

VENDIM

- MIRATOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik ekonomik "Olti Trasing" Shpk – Sheshi Bill Klinton, pn.- Prishtinë, Rep. e Kosovës, p.n
- ANULOHET Vendimi, përkatësisht Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhënie e kontratës i publikuar në ueb faqen e platëformës elektronike të KRPP-së me datë 09/09/2020.
- Të mirren masa adekuate korrigjuese për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që me konrtatë publike për aktivitetin e lartcekur të prokurimit të shpërblehet oferta e Operatorit Ekonomik ekonomik, "Olti Trasing" Shpk – Sheshi Bill Klinton, pn.- Prishtinë, Rep. e Kosovës si ofertë e përgjegjshem me çmimin më të ulët që plotëson të gjitha kriteret e specifikuara në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet (GOE "Edona"Sh.p.k; "Company Murseli"Sh.p.k "Suvatimi"Sh.p.k;)

Ne jemi njoftuar me letrën standarde për tenderues të eliminuar me dt. 09.09.2020, me arsyetimin se "*Ju nuk i keni përmbushur të gjitha kërkesat tek kapaciteti teknik dhe profesional, përkatësisht kërkesat 1, 2 dhe 4.*"

Ju sqarojmë se arsyetimi i AK-së ku e ka cekur se ne nuk e kemi dorëzuar listën e kontratave sipas aneksit 6 të dosjes së tenderit është i paqëndrueshëm sepse lista e kontratave të paraqitura nga ana jonë nuk dallon fare në substancë me listën të cilën e ka kërkuar AK-ja, pasi që ne kemi ofruar edhe dëshmitë si referencat dhe procesverbalet teknike në lidhje me kontratat të cilat i kemi prezantuara në listë, andaj lista e prezantuar nga ne mund të cilësohet si devijim i vogël sipas nenit 59.4 të LPP-së pika (ii) pasi që ky devijim nuk mund të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosien e tenderit, për faktin se ne e përmbushim këtë kërkesë.

Mirëpo nëse AK-ja ka pasur ndonjë dyshim në lidhje me listën e kontratave të dorëzuara nga ana jonë, atëherë ka mundur të kërkoj sqarime shtesë në bazë të dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ku ne do të ju kishim dhënë në detaje sqarimet e kërkuara, andaj kjo arsye e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit është e pa bazuar dhe nuk qëndron fare.

Në lidhje me arsyen e dytë të AK-së për eliminimin tonë ku e ka cekur se menaxheri i projektit i caktuar nga ana jonë z.Elnaim Ymeri ka kontratë me KK Gjilan në projektin Hartimi i Projekteve në infrastrukturën rrugore, ju sqarojmë se as kjo arsye nuk qëndron për faktin se nuk ka asnjë dëshmi se i njëjti inxhinier ka marrë pjesë në hartimin e projekteve konkretisht për tenderin "Ndërtimi i ri i stacionit të autobusëve".

Për më tepër i njejti ingjinjer është i punësuar tek liderii konzerciumit Edona Shpk, prandaj në këtë rast nuk ka asnjë dilemë në lidhje me përmbushjen e kërkesave nga ana jonë dhe nuk ka asnjë dilemë për konflikt interesi të këtij ingjinjeri me Komunen.

Sa i përket arsyes së tretë të eliminimit ku AK-ja e ka cekur se ne nuk e kemi prezantuar listën e pagave për 20 punëtorë, ju sqarojmë se kjo arsye është e paqëndrueshme për faktin se ne e kemi prezantuar listën e pagave për 20 punëtorë nga kompania, pra ne e kemi prezantuar listën ashtu siç është kërkuar në FDT "*Lista e pagave të OE. Duhet të dorëzohet origjinal ose kopje e noterizuar*" pra kërkesa ka qenë shumë e qartë, lista e pagave nga operatori ekonomik mirëpo nuk është kërkuar decidivisht që lista duhet të jetë nga ATK-ja, mirëpo sa për korrektësi **bashkangjitur keni listën e pagave edhe nga ATK-ja.**

Pra duke u bazuar nga faktet e lartpërmendura shihet qartë se ne jemi OE i cili i përmbush të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe gjithashtu jemi OE më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë për **163,095.42 €**, andaj edhe është dashur të rekomandohemi për kontratë dhe jo të diskriminohemi në këtë mënyrë duke u eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit pa ndonjë bazë ligjore.

Ne pajtohemi me arsyet e AK për eliminimin e operatorëve ekonomik **AC ing SH.P.K. & Acon SH.P.K dhe Arhiko ING O.P & AL-GROUP SH.P.K.**

Ne me dt. 16.09.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.

AK-ja me këtë arsyetim të tyre vetëm sa po i vërteton edhe më shumë se pretendimet tona ankimore se janë të bazuara, pasi që nëse nuk do të ishin të bazuara atëherë autoriteti kontraktues do ti sqaronte arsyet se për nuk janë të bazuara, mirëpo në këtë rast nuk ka ofruar asnjë dëshmi konkrete në lidhje me pretendimet tona ankimore, mirëpo vetëm e ka cekurës pretendimet tona bien poshtë dhe mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e AK-së.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartpërmendura shihet qartë se arsyetimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe nuk qëndron.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i **përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka eliminuar neve edhe pse ne jemi OE më i lirë se OE i rekomanduar për kontratë për **163,095.42 €** dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha **aspektet përmbajtjesore** të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e **Konzersiumit *"Edona"Sh.p.k"*; "Company Murseli" Sh.p.k*"Suvatimi"Sh.p.k;*** si e bazuar,

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet GOE "AC ing "Sh.p.k & "A CON"Sh.p.k;

Te nderuar pasi kemi pranuar "Njoftimi i AK dhe Letrat Standarde.pdf "për tenderuesin e eleminuar me datë :09.09.2020 ne ora 13:42 ne web faqen e E-PROKURIMIT,ku na keni eleminuar me arsyetimin se : Komisioni gjate vlersimit dhe ekzaminimit te ofertave duke u bazur ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate gjegjesisht te Kapaciteti teknik dhe Profesional 9.1&9.2 në Kërkesdë 2 sipas DT eshte kerkuar qe:

Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilet duhet të kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme, 4 (katër) saldues të çertifikuar

Ne dosjen e ofertuarte nga ju si Grup i Operatorve Ekonomik AC ING SH.P.K; A CON SH.P.K komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju mungojne Kontratat, CV, dhe referencat e salduesve ku edhe te çertifikata e salduesit Artan Dashi nuk perputhet numri i çertificates me numrin e verifikimit ku Nr: I Cer eshte ER-414-QTW ndersa linku për verifikim është http: //www.easicc.com/er/114qtwtraining.

Në lidhje me arsyen e eleminimit nga ana jua ju sqarojm se pretendimet e komisionit te vlersimit janë të pa bazuar sepse salduesve i mungojn: Kontratat, CV, dhe referencat e salduesve nuk ka qene kërkes e FDT për dorëzim.

Në dosjen e tenderit të korigjuar për herë te fundit me datë 07.07.2020 të ngarkuar ne E-prokurim ka qenë kërkesa vetem për certfikat kopje per saldues- **(Dëshmia 2 Për te gjithë personelin profesional - Për menaxherin e Projektit si dhe Personelin Kryesor Teknik, të paraqiten Diplomt përkatëse te noterizuar , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit.Nje ashtu per salduesit kopja e cerifikates). (Gjeni te bashkangjitur dosjen e fundit me date 07.07.2020)**

Në lidhje me pretendimin e dytë ju sqarojm se pretendimet e komisionit te vlersimit janë të pa bazuar sepse salduesi Artan Dashi posedon çertfikaten me numer Nr: I Cer eshte ER-414-QTW e cila mundë të verfikohet shumë lehtë duke e shenuar linkut :www.easicc.com/er/114qtwtraining i cilin gjindet në certifikat dhe do të hapet certifikata ne web faqen e internetit.

Ne si kompani ju kemi drejtuar në e-mail :info@easicc.com me datë:11.09.2020 për shpjegim nga ana e trupave çertifikuse për pretendimet e komision dhe kemi pranuar këtë përgjigjje në lidhje me çertifikatene e Artan Dashit me datë 15.09.2020 dhe nuk kemi mundur të dorëzojm në AK-se sepse afati për ri-shqyrtim ka qenë deri me 14.09.2020 sipas LPP.Prandaj po e bashkangjitim si dëshmi.(Gjeni të bashkangjitur përgjigjjen).

Andaj ju si AK-se nuk e keni respektu nenin 59 të LPP-së ,sepse na keni eleminuar neve si GOE edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe te njoftimit për kontratë,ndërsa e kemi plotësuar edhe kriterin kryesore për dhenie të kontratës,e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ultë sipas nenit 60 paragrafit 1.1 i LPP-së.

Ju si AK-së në këtë vlerësim dhe vendim na keni diskriminuar neve si GOE në kundërshtim me nenin 7-të LLP-së dhe njëkohësisht e keni favorizuar GOE të rekomanduar për kontratë,ndërsa në paragrafin 1 të nenit 7 të LPP-së parashihet qartë "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo -diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Ju si AK-së është dashur ta keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së,pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën me efikase ,më transpartente dhe më të drejtë të shfrytëzimit te fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu ju si AK-së nuk e keni respektuar edhe nenin 6 të LPP-së,sepse jeni te obliguar që të siguroni se fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike,njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Ndërsa ju me këtë vendim keni demtuar buxhetin e konsoliduar të Kosovës për 216,413.09€ e shprehur në përqindje 42.17% më shumë se oferta jonë.Në fund kërkojmë nga OSHP-ja ,që të nxjerr:

VENDIM

Aprovohet ankesa e GOE "AC ING"Sh.p.k & "A CON "Sh.p.k,si e bazuar.

Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së.

Te nxjerret vendimi nga OSHP-ja ku ne të shpallemi fitues si GOE i përgjegjesh me çmim më të ultë.

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet OE BM Grup Sh.p.k

Me datën 09.09.2020 AK ka publikuar "B 58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK" përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net, ku si fitues të propozuar për kontratë është shpallur i Grup i Operatorve Ekonomik "Globi - M.I. SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundershtim me nenin 7, 59, dhe 72 të LPP-së, na keni eliminuar neve nga ky aktivitet i prokurimit me arsytimin se:

9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

I .*Per skelę mbajtëse*

Për skele mbajtëse ne kemi ofruar marrëveshjen për qiradhënje të skeleve nga kompania Timo Construction Sh.p.k. Duke mos kërkuar sqarim shtesë ju si AK keni shkelur LPP, respektivisht Nenin 69 të LPP-së , pika 2 dhe 2.2 .

Duke pas parasysh se oferta jonë ka qenë oferta më e lirë ë se sa oferta e operatorit që e keni rekomanduar për kontratë, keni qenë të obliguar që të zbatoni nenin 72 dhe 59 të LPP-së të bëni vlerësim korrektë duke kërkuar sqarime nga ana e jonë lidhur me Listen e pajisjeve te dorëzuar sepse ne jemi te bindur se Lista jonë i ploteson te gjitha specifikat dhe karakteristikat siç është kërkuar në FTD, si dhe konform me Neni 69 - LPP-së , kërkoni sqarim rreth listes së pajisjeve e jo të na eliminoni pa bazë dhe duke favorizuar Grupin e operatorëve ekonomik të janë më të shtrenjët se ne.

Bazuar në faktet e lartëcekura AK me rastin e favorizimit dhe rekomandimit për kontratë të Grupit i Operatorve Ekonomik "Globi - M.I. SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION". ka bërë shkelje të nenit 1 dhe 6 të LPP-së sepse qëllimi i këtij ligji është që AK të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoritetit kontraktuese.Ndersa ju si AK keni rekomanduar për kontratë **Grupit i Operatorve Ekonomik** "Globi - M.I. SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION". me vlerë të ofertës prej **729,542.20 €**, e cila ofertë është më e shtrejtë se sa oferta e jonë **"BM Group"** Sh.p.k e cila është në vlerë prej **659,986.13 €**.

Respektivisht ju keni dëmtuar buxhetin e Komunes tuaj si dhe interesin publik me rastin e rekomandimit për kontratë të **Grupit të Operatorve Ekonomik** "Globi - M.I. SH.P.K.; N.N.P. EURO CONSTRUCTION.në vlerë prej **69,556.07 €**.

AK-ja ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së ku nuk na ka kërkuar sqarime shtesë lidhur me listën e pajisjeve, në kësaj Kërkesë për Rishqyrtim ja bashkangjisim listën e pajisjeve siq është kërkuar në FTD.

Për Grupin e Operatorëve Ekonomik të tjerë Autoriteti Kontraktues ka zbatuar ligjin e prokurimit dhe rregulloren duke u mbeshtetur në nenet dhe në dokumentet qe Ata si OE nuk i plotësojnë kushtet dhe nuk janë të përgjegjshëm për realizimin e projektit.

Për Grupin e OE - AC ing dhe A Con Sh.p.k mungojnë :

Te Kapaciteti teknik dhe Profesional 9.1&9.2 në Kërkesën 2sipas FDT eshte kerkuar qe Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilet duhet te jenë me kualifikime shkollore te meposhtme, 4 saldues të çertifikuar.

*Ne dosjen e ofertuar nga Grup i Operatorve Ekonomik **AC ING SH.P.K; A CON SH.P.K**,komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju mungojne **Kontratat, CV, dhe referencat e salduesve ku edhe te certifikata e salduesit Artan Dashi nuk perputhet numri i certificates me numrin e verifikimit ku Nr: I Certifikatës është ER-414-OTW ndërsa linku http://www.easicc.com/er/114atwtraining.***

Ne si OE pajtohemi me vendimin e AK ne lidhje me Grupin e OE - AC ing dhe A Con Sh.p.k. AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së .

Për Grupin i OE Arhiko ING o.p; AL-GROUP SH.P.K mungojnë:

Te Kapaciteti teknik dhe Profesional 9.1&9.2 në Kërkesën 2 sipas FDT eshte kerkuar qe Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilet duhet te jenë me kualifikime shkollore te meposhtme, 4 saldues të çertifikuar.

*Ne dosjen e ofertuar nga Grup i Operatorve Ekonomik **Arhiko ING o.p; AL-GROUP SH.P.K** komisioni i vlersimit nga AK ka konstatuar se i mungon validiteti i qertifikatës se saldimit **te z.Musli Sallahu ku kjo certifikat ka pasur vadilitet deri me date: 15.07.2019.***

Ne si OE pajtohemi me vendimin e AK ne lidhje me Grupin e OE - AC ing dhe A Con Sh.p.k. AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së .

Për Grupin i OE Edona Sh.p.k.; SUVATIMI SH.P.K; Company Murseli SH.P.K mungojnë:

1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve..sipas Aneksit 6 te DT.

*Në dosjen e ofertuar nga ju si Grup i Operatorve Ekonomik Edona Sh.p.k.; SUVATIMI SH.P.K; Company Murseli SH.P.K. komisioni i vlersimit nga AK ka konstatuar se nuk e keni dorzuar **Listen e Kontrateve sipas Aneksit 6 sipas DT.***

2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme Menaxher i projektit 1. Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose arkitekturës, me 3 vite përvojë punë pas diplomimit.

*Ne dosjen e ofertuar nga ju si Grup i Operatorve Ekonomik Edona Sh.p.k.; SUVATIMI SH.P.K; Company Murseli SH.P.K. komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju si Grup i OE ka caktuar Menaxher Projekti **z.Elnaim Ymeri ku ky ing ka kontrat me KK Gjilan ne projektin Hartimi i Projekteve në infrastrukturën rrugore.***

3. Kërkesa 4 Operatori ekonomik duhet të ketë te punesuar min.20 punëtor. Listën e pagave të operatorit ekonomik. Duhet të dorëzohet origjinal ose kopje e noterizuar. Ne dosjen e ofertuar nga ju si Grup i Operatorve Ekonomik Edona Sh.p.k.; SUVATIMI SH.P.K; Company Murseli SH.P.K. komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju si Grup i OE se nuk e keni dorezuar listen e pagave per 20(njezet) punitore.

Ne si OE pajtohemi me vendimin e AK ne lidhje me Grupin e OE - AC ing dhe A Con Sh.p.k. AK duke rrespektuar ligjin e LPP dhe RROUPP respektivisht , Nenin 69 te LPP dhe Neni 39-te Rroupp-së .

Për Grupin i OE ARIANI CONSTRUCTION SH.P.K.; ALPING SH.P.K; Enggroup SH.P.K; Arch - Ndertimi SH.P.K

Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme : per salduesit e certifikuar të paraqiten Diplomi përkatëse te noterizuar , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar ngapunëdhënësit.Nje ashtu per salduesit kopja e cerifikates enoterizuar. Ne dosjen e ofertuar nga ju si OE ARIANI CONSTRUCTION SH.P.K.; ALPING SH.P.K; Enggroup SH.P.K; Arch - Ndertimi SH.P.K_komisioni i vlersimit ka konstatuar se ju si Grup i OE i mungon ***validiteti i certifikuesve sepse nuk e kan bërë datën e rileshimit ku sipas standardeve ISO çdo certifikat ka afat validiteti 3(tre) vjeçar ku per çdo vite kerkohet te behet riauditimi apo rileshimi i certificates ku keto certifikata datën e leshimit e kan me date 27.11.2018 dhe nuk kanë datë tjetër të rileshimit.***

